



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:278046
Datë: 23.04.2024
Numri i dokumentit: 05632524

AA.nr.511/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Delushe Halimi kryetare e kolegjit, Ramiz Kuqi dhe Hajriz Hoti, anëtarë, në konfliktin administrativ të paditësve M. S. dhe A. S. të dy ish nga Gj., të cilët i përfaqëson avokat F.Gj. nga P., kundër të paditurës Agjencia Kadastrale e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësve, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.604/2019, të datës 19.04.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më 23.04.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësve M. S. dhe A. S., e datës 30.05.2023, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.nr.604/2019, të datës 19.04.2023, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, me aktgjykimin e ankimuar në pikën I të dispozitivit ka vendosur: Refuzohet kërkesëpadia e paditësve M. S. dhe A. S., me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi i Agjencisë Kadastrale të Kosovës me numër ... të datë ..., si e pa bazuar. Në pikën II. Mbetet në fuqi vendimi me numër ... të datë ..., i të paditurës Agjencia Kadastrale e Kosovës në Prishtinë. Në pikën III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar i autorizuari i paditësit, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, Aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj dhe ta shfuqizojë aktvendimin e të paditurit ose të njëjtin ta prishë dhe lëndën t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në vendosje të serishme.

Gjykata e Apelit shqyrtoi shkresat e lëndës, Aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 49, të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), dhe neni 194 i LPK-së, ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjen se;

Ankesa është **e pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura me vendimin me nr.të referencës ... të datë ..., e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e paditësve M. S. dhe A. S., kundër aktvendimit me nr.... të datës ... të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër dhe Pronë KK Gj. .

Paditësit, të pa kënaqur me këtë vendim kanë ushtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kundër të paditurit, duke pretenduar se vendimi i tij është jo ligjor. Gjykata e shkallës së parë, për këtë çështje mban seancë të shqyrtimit kryesor, më dt.19.04.2023, dhe pas administrimit të provave si dhe shkresave tjera të lëndës bien aktgjykimin e ankimuar me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësve, si të pa bazuar, me arsyetim se e paditura në vendimin e sajë drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, kur ka vendosur që ankesën e të paditësve ta refuzoj si të pa bazë ligjore, ngase e njëjta çështje është në zhvillim e siper në procedurë kontestimore, në bazë të provave me të cilat i ka ofruar pala e paditur dhe në bazë të provave të ofruar vërtetohet se Komuna e Gjakovës ka inicuar procedurë kontestimore me padi dhe masë të sigurisë për nulitetin e kontratave për rregullimin e Tokës Ndërtimore dhe deri më tani ende nuk ka prova që është vendos në çështjen kontestimore. Andaj lidhur me çështjen paraprake të të njëjtës çështje, gjykata iu referua Ligjit të Përgjithshëm të Procedurës Administrative, dispozitës ligjore, përkatësisht nenit 85 i cili parasheh: *“Kur organi publik që zhvillon procedurën has në një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e çështjes kryesore dhe e cila përbën një çështje juridike të pavarur (në vijim: ”çështje paraprake”), për zgjidhjen e së cilës është kompetente një gjykatë apo organ tjetër, organi publik që zhvillon procedurën do të pezullojë çështjen kryesore, deri sa çështja paraprake të jetë vendosur dhe do të njoftojë palën për vendimin e pezullimit”*. Gjykata iu referua edhe Ligji Nr. 04/L-009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 2002/ 5 për Themelimin e Regjistrimit të Drejtave të Pronës së Paluajtshme ,neni 4 *“Neni 3. i ligjit bazik, paragrafi 3.7. ndryshohet dhe riformulohet si vijon: 3.7. Të drejta mbi pronën e paluajtshme që parashihen sipas nenit 2 të ligjit regjistrohen në bazë të: a). vendimit të plotfuqishëm të gjykatës; b). vendimit të organit administrativ shtetëror; c). kontratës për bartjen e së drejtës së pronës së paluajtshme të vërtetuar nga organi kompetent; 2 d). vendimit apo kontratës për privatizim të lëshuara nga Agjencia Kosovare e Privatizimit; e). vendimit të Komisionit për rindërtimin e kadastrit; f). vendimit të Komisionit për rregullimin e tokave; dhe g). dokumentit tjetër që me ligje të veçanta parashihet regjistrimi i të drejtave pronësore”*. Duke iu referuar edhe Udhëzimit Administrativ nr. 2004/3, nenit 5 të të njëjtit i cili përcakton bazën ligjore për regjistrim. Regjistrimi i një të drejte mbi pronën e paluajtshme mund të bazohet në një dokument valid nga një organ kompetent gjyqësor apo administrativ, vendim përfundimtar nga gjykata kompetente dhe me një transaksion ligjor, që përputhet me dispozitat e ligjit në fuqi. Mbi këtë bazë, gjykata gjeti se e paditësit nuk kanë ofruar asnjë provë me të cilën do të vërtetohet e drejta e tyre sipas padisë dhe e cila do të kishte ndikuar në ndryshimin e vendimit të atakuar.

Mbi këtë bazë, gjykata i pranoi si të ligjshëm dhe të drejtë refuzimin e të paditurës ndaj ankesës së palës dhe në lidhje me këtë, gjykata gjeti se e paditura ka zbatuar siç duhet ligjin material, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe ka vendosur në tërësi konform nenit 132 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Andaj, duke u bazuar në këto prova dhe në dispozitat e sipërcituara, gjykata vlerëson se vendimi i goditur me padi është i drejtë dhe i bazuar në gjendjen e vërtetuar faktike.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë në tërësi e aprovon si të rregullt, ligjor dhe të drejtë, sepse aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të ligjit për konfliktet administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i vlerëson sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit të 194 të LPK-së. Gjykata e shkallës së parë, sipas kompetencës nga LKA, ka shqyrtuar dhe vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të paditurës, të atakuar me padi i cili vendim i ka të parapara argumentet në të cilat është bazuar në arsyetimin e tij, ku janë dhënë arsye të mjaftueshme mbi faktet vendimtare në të cilat është bazuar e të cilat kolegji i miraton si të drejta dhe të bazuara në ligj, sepse në mënyrë të plotë dhe të drejtë është vërtetuar gjendja faktike dhe drejtë është zbatuar e drejta materiale.

Gjykata e shkallës së parë në këtë çështje juridike administrative sipas provave të administruara siç janë Aktvendimi i te paditurës nr. ... dt. ..., Ankesa e përbashkët drejtuar te paditurës nr.... dt...., Kërkesa për regjistrimin e paluajtshmerisë me nr. proto. ... dt. ..., Njoftimi nga Komuna e Gjakovës dt. ..., Vendimi nga Komuna e G. me nr. ... dt. ..., Kontrata mbi rregullimin e tokës ndërtimore e lidhur ne mes paditësve dhe fondit për toke ndërtimore me nr. ... dt. ..., Kontrata mbi rregullimin e tokës ndërtimore e lidhur ne mes paditësve dhe fondit për toke ndërtimore me nr. ... dt. ..., Vendimi nga Komuna e Gjakovës nr. ... dt. ..., Kontrata mbi rregullimin e tokës ndërtimore e lidhur ne mes paditësve dhe fondit për toke ndërtimore me nr. ... dt...., Padia e ngritur nga Komuna e Gj. bashke me propozim për caktimin e masës se sigurisë nga Komuna e Gj., Kërkesa numër ... dt., Kopja e planit me nr parcelësGJJ qytet e dt. ..., Kopja e planit me nr parcelës ... GJJ qytet e dt. ..., Ekspertize për Komisionin për shqyrtimin e kërkesave ne kompleksin “Rr.”, Mendim Komuna e Gj. me nr dt. ...- Komisioni për shqyrtimin e trojeve ne kompleksin urbanistik “R.”, Mendim Komuna e Gj...me nr.... dt. ...- Komisioni për shqyrtimin e trojeve ne kompleksin urbanistik “R.”, Konkluzion AKK nr.... dt. ... Agjencia Kadastrale e Kosovës, Informim lidhur me Konkluzionin e marre nga AKK dt.... Nr...., Imella zyrtare nga V.Sh., Përgjigje ne kërkesë me nr....dt.... nga Komuna e Gj., Kërkesë për ngritje te padisë dt.08.02.2016, Ankesa drejtuar Agjencia Kadastrale e Kosovës me nr. ... dt. 27.11.2018, Vendimi nga Komuna e Gjakovës nr. ... dt.20.11.2018 mbi pezullim e kërkesës dt.20.11.2018, ka konstatuar me të drejtë mos përmbushjen nga ana e paditësit të kushteve nga neni 4 të Ligjit Nr.04/L-009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.2002/5 për Themelimin e Regjistrimit të Drejtave të Pronës së Paluajtshme, ku përcaktohet: *“Neni 4- Neni 3. i Ligjit bazik, paragrafi 3.7. ndryshohet dhe riformulohet si vijon: 3.7. Të drejtat mbi pronën e paluajtshme që parashihen sipas nenit 2 të ligjit regjistrohen në bazë të: a). vendimit të plotëfuqishëm të gjykatës; b). vendimit të organit administrativ shtetëror; c). kontratës për bartjen e së drejtës së pronës së paluajtshme të vërtetuar nga organi kompetent; 2 d). vendimit apo kontratës për privatizim të lëshuara nga Agjencia Kosovare e Privatizimit; e). vendimit të Komisionit për rindërtimin e kadastrit; f). vendimit të Komisionit për rregullimin e tokave; dhe g). dokumentit tjetër që me ligje të veçanta parashihet regjistrimi i të drejtave pronësore”*. Në këtë drejtim, paditësit nuk kanë ofruar asnjë provë me të cilën do të vërtetohet e drejta e tyre sipas padisë dhe e cila do të kishte ndikuar në ndryshimin e vendimit të atakuar.

Sa i përket shkeljeve të dispozitave procedurale, meqë gjykata e Apelit kujdeset për këto në bazë të detyrës zyrtare, nuk qëndrojnë, meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht i ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së. Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore për gjykim jo të drejtë, se në aktgjykimin e ankimuar gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsye bindëse për faktet vendimtare, ngase pretendimet e dhëna janë të pamjaftueshme, si dhe nuk ka vlerësuar saktësinë e provave dhe nuk ka paraqitur qartë dhe në plotëni se cilat fakte dhe për çfarë arsye i trajton të vërteta apo të pa vërteta. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoi, ngase konsideron

se gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se paditësi nuk i ka përmbushur kushtet ligjore nga neni 4 i Ligjit nr.04/L-009 për ndryshimin e dhe Plotësimin e Ligjit nr.2002/5 për Themelimin e Regjistrimit të Drejtave të Pronës së Paluajtshme, i njëjti nuk ka prezantuar as para të paditurës dhe as para gjykatës një akt juridik të vlefshëm siç parashihet në nenin e lartcekur. Prandaj, në këtë rast gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar edhe të drejtën materiale kur është bazuar në dispozitat e LPA, LKA, Ligjit për Themelimin e Regjistrimit të Pronës së Paluajtshme nr.2002/5 dhe Udhëzimit Administrativ nr. MSHP 2004/3, për Zbatimin e Ligjit mbi Themelimin e Regjistrimit për të Drejtat në Pronën e Paluajtshme.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e refuzimit të padisë së paditësit dhe lënies në fuqi të vendimit të lartpërmendur, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – PRISHTINË
AA.nr.511/2023, me datë 23.04.2024

Kryetare e kolegjit,
Delushe Halimi